

VENDIM
Nr.957,datë 25.11.2015

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR NIVELET UDHËZUESE TË
PËRQËNDRIMIT TË RADONIT NË MJEDISËT E BRENDSHME DHE
PËRQËNDRIMET E RADIOBËRTHAMAVE NË MALLRA, ME EFEKT
MBROJTJEN E PUBLIKUT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të paragrafit 1, të nenit 9,të ligjit nr.8025,datë 9.11.1995, “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese ”,të ndryshuar,me propozimin e ministrit të Shëndetësisë,Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

- 1.Miratimin e rregullores ‘‘Për nivelet udhëzuese të përqëndrimit të radonit në mjediset e brendshme dhe përqëndrimet e radiobërthamave në mallra,me efekt mbrojtjen e publikut’’,sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
 - 2.Vendimi nr.591,datë 18.8.2011 ,i Këshillit të Ministrave,“Për miratimin e rregullores“ Për nivelet e lejuara të përqëndrimit radonit në ndërtesa dhe ujë,nivelet udhëzuese të radiobërthamave në materialet e ndërtimit,si dhe nivelet e lejuara të radiobërthamave në ushqime dhe produkte kozmetike ‘’’ shfuqizohet.
 - 3.Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe të gjitha institucionet e përmendura në rregullore për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

RREGULLORE
PËR NIVELET UDHËZUESE TË PËRQËNDRIMIT TË RADONIT NË MJEDISËT E
BRENDSHME DHE PËRQËNDRIMET E RADIOBËRTHAMAVE NË MALLRA, ME
EFEKT MBROJTJEN E PUBLIKUT

Neni 1
Objekti i rregullores

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i niveleve të referencës për përqëndrimin e radonit në vendet e punës e godinat e banimit dhe për përqëndrimin e radiobërthamave në ujë të destinuar për konsum publik, materiale ndërtimi, skrape, në produktet ushqimore, ushqimet për kafshët dhe produktet kozmetike të kontaminuara si rezultat i një aksidenti bërthamor apo emergjence radiologjike, si dhe për të marrë masa kontrolli për të siguruar mbrojtjen e publikut e të mjedisit nga efektet e dëmshme të rrezatimit jonizues.

Neni 2 Përcaktimet

Në kuptim të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

- a) “Produkt bujqësor”, çdo prodhim ushqimor për konsum njerëzor dhe ushqim për kafshët;
- b) “Material ndërtimi”, çdo material i cili vendoset në mënyrë të përhershme në një ndërtesë ose pjesët e saj, prania e të cilit ka efekt në ekspozimin e publikut nga rrezatimet jonizuese;
- c) “Ngarkesë”, sasia e çdo produkti, pjesë e të njëjtit dokument, i transportuar me të njëjtën mënyrë transporti dhe që vjen nga i njëjti vend origjine;
- ç) “Produkt kozmetik”, çdo substancë ose përzierje substancash e destinuar për t’u vendosur në kontakt me pjesë të ndryshme të trupit të njeriut (epidermë, flokë, thonj, buzë dhe organe gjenitale të jashtme) ose me dhëmbët dhe mukozat e membranave të kaviteve orale për pastrimin, aromatizimin e tyre, ndryshimin e pamjes ose ndryshimin e aromës së trupit dhe/ose mbrojtjen e mbajtjen e tyre në kushte të mira;
- d) “Ushqimi”, produkt i cili është i destinuar për konsum njerëzor si material bazë ose i përpunuar;
- dh) “Ushqimi për kafshët”, produkt i cili është i destinuar vetëm për ushqimin e kafshëve;
- e) “Burim i humbur”, një burim radioaktiv i cili nuk është as i përjashtuar, por as nën kontrollin rregullator, sepse ai kurrë nuk ka qenë nën kontrollin rregullator ose/sepse ka qenë i braktisur, i humbur, i zhvendosur, i vjedhur ose i transferuar pa autorizimin e duhur;
- ë) “Radon”, radiobërthama Rn-222, si dhe pasardhësit e tij në familje;
- f) “Masë përmirësuese”, largimi i burimit radioaktiv, kufizimi i aktivitetit, ndërprerja e rrugëve të ekspozimit, zvogëlimi i ndikimit të tyre me qëllim ndalimin ose zvogëlimin e dozës, që mund të merret në një situatë ekspozimi ekzistuese;
- g) “Nivel reference”, niveli i dozës efektive ose dozës ekuivalente apo përqendrimi i aktivitetit mbi të cilin është gjykuar si e papërshtatshme të lejohen ekspozime, edhe pse ky nuk është një limit që nuk mund të tejkalohet;
- gj) “Ujë i destinuar për konsum njerëzor”, është:
 - i) uji në gjendjen e tij natyrale ose pas trajtimit, i destinuar për t’u pirë, për gatim, përgatitje ushqimi ose qëllime të tjera shtëpiake, pa marrë parasysh origjinën e tij, nëse vjen nga një rrjet furnizimi, një cisternë, shishe ose depozita;
 - ii) uji që përdoret në industrinë ushqimore me qëllim për të prodhuar, përpunuar, ruajtur apo tregtuar produkte ose substanca për konsum njerëzor, derisa autoriteti kombëtar kompetent është i sigurt që cilësia e ujit nuk mund të ndikojë në vlerat ushqimore të produktit përfundimtar.

PJESA I
NIVELI UDHËZUES PËR PËRQENDRIMIN E RADONIT NË MJEDISËT E
BRENDSHME

Neni 3
Plani i veprimit për radonin

1. Institucionet kombëtare, nën kryesimin e Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet (KMR), të cilit i referohemi, hartojnë programin kombëtar për rreziqet afatgjata nga ekspozimi i radonit në banesa, godina publike dhe vendet e punës.
2. Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar (IFBZ), të cilit i referohemi, dhe institucione të tjera identifikojnë zonat ku përqendrimi i radonit (i konvertuar në dozë mesatare vjetore) për një numër të konsiderueshëm mjedisesh pritet të kalojë nivelet udhëzuese që jepen në nenet 4 dhe 5, të kësaj rregulloreje. Ky informacion i dërgohet Zyrës së Mbrojtjes nga Rrezatimet (ZMR) në rrugë zyrtare.
3. Radoni në ndërtimet e reja nuk duhet të kalojë nivelet udhëzuese që jepen në nenet 4 dhe 5, të kësaj rregulloreje.

Neni 4
Përqendrimi i radonit në vendet e punës

1. Përqendrimi mesatar vjetor i radonit në mjediset e brendshme të vendeve të punës nuk duhet të kalojë 300 Bq/m^3 .
2. Me qëllim kontrollimin e përputhshmërisë së vlerës udhëzuese të përcaktuar në pikën 1, matjet e radonit duhet të kryhen nga persona fizikë apo juridikë të njohur nga ana e KMR-së. Matjet e radonit kryhen në vendet e punës, si më poshtë:
 - a) Vendet e punës nëntokësore, ku përfshihen minierat, tunelet, llixhat, instalimet nëntokësore, katakombet, shpellat dhe guvat turistike, stacionet nëntokësore të ruajtjes dhe përpunimit të ujit;
 - b) Vendet e punës mbitokësore, ku përfshihen fabrikat, magazinat, dyqanet ose vendet e tjera të punës ku përdoren, përpunohen ose ruhen lëndët e para me përqendrim të lartë të Ra-226;
 - c) Çdo vend pune tjetër për të cilin KMR-ja ka arsye të besojë se publiku ose punonjësit janë të ekspozuar ndaj përqendrimeve të larta të radonit.
3. Personat fizikë ose juridikë paraqesin pranë KMR-së metodologjinë për kryerjen e matjeve.
4. Në rast se rezultatet e matjeve të kryera në përputhje me pikën 2 tregojnë një përqendrim mesatar vjetor të radonit në vendet e punës më të lartë se 300 Bq/m^3 , personi i njohur për kryerjen e veprimtarisë duhet të marrë masa në vendet e punës për të zvogëluar përqendrimin e radonit, në të cilat përfshihen:
 - a) kufizimi i kohës së ekspozimit;
 - b) kontrolli i hyrjeve;

- c) monitorimi i vendit të punës;
- ç) ventilimi;
- d) masa mbrojtëse respiratore;
- dh) masa inxhinierike të godinës për të zvogëluar hyrjen e gazit radon.

Pas përmirësimit të kryhet një rivlerësim i përqendrimit të radonit në vendet e punës.

5. Në rastin kur, megjithëse janë marrë të gjitha masat në përputhje me pikën 3, përqendrimi mesatar i radonit vazhdon të kalojë 300Bq/m^3 , personat e njohur që ushtrojnë aktivitetin njoftojnë KMR-në, e cila vendos për masat e mbrojtjes nga rrezatimi jonizues në përputhje me rregulloren nr.590, datë 18.8.2011, “Për mbrojtjen e punëmarrësve të ekspozuar profesionalisht ndaj rrezatimeve jonizuese” dhe rregulloren nr.10, datë 7.1.2010, “Për licencimin dhe inspektimin e veprimtarive me burime të rrezatimeve jonizuese”.

Neni 5

Përqendrimi i radonit në ndërtesat e banimit dhe godinat publike

1. Përqendrimi mesatar vjetor i radonit në mjedisin e brendshëm të ndërtesave të banimit dhe godinave publike nuk duhet të kalojë 300Bq/m^3 .
2. Me qëllim kontrollin e përputhshmërisë të përqendrimit të radonit në ndërtesat e banimit dhe godinat publike me vlerat udhëzuese të dhëna në pikën 1, të këtij neni, matjet e përqendrimit të radonit kryhen nga Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar (IFBZ) dhe institucione të tjera të njohura nga KMR-ja.
3. Institucionet përgjegjëse për matjet e radonit duhet të paraqesin në KMR metodologjinë e kryerjes së matjeve.
4. Në ato ambiente ku përqendrimi mesatar vjetor i radonit është gjetur më i lartë se 300Bq/m^3 , pronarët e ndërtesave të banimit duhet të marrin masat e duhura për të zvogëluar përqendrimin e radonit.
5. Në rastin e ndërtesave të banimit, KMR-ja informon publikun për shkallën e përqendrimit të radonit në mjediset e brendshme, rrezikun në shëndet, për rëndësinë e kryerjes së matjeve dhe masave mbrojtëse, që ndikojnë në zvogëlimin e përqendrimit të radonit.
6. Në rastin e godinave publike, KMR-ja ka të drejtën të zbatojë sanksione për zbatimin e masave përmirësuese.

PJESA II

Neni 6

Nivelet udhëzuese për radiobërthamat në ujin për konsum publik

1. Përqendrimi i radonit në ujin për konsum publik nuk duhet të kalojë vlerën 100Bq/l .

2. Përqendrimi i tritiumit në ujin për konsum publik nuk duhet të kalojë vlerën 100Bq/l.
3. Përqendrimi i të gjitha radiobërthamave të zbuluara në furnizuesit e ujit për konsum publik, përjashtuar tritium, kalium-40, radon dhe produktet me periudhë të shkurtër gjysmëzbërthimi duhet të jenë të tilla që doza efektive e shkaktuar në një vit të mos kalojë 0.1mSv.

Neni 7

Monitorimi i përputhshmërisë

1. Për të kontrolluar përputhshmërinë e niveleve udhëzuese të përcaktuara në nenin 6, monitorimi i ujit i destinuar për konsum publik duhet të kryhet në bazë të metodikave të miratuara nga KMR-ja.
2. Monitorimi i ujit i destinuar për konsum publik duhet të kryhet në pikat e mëposhtme:
 - a) Në rastin e ujit që vjen nga rrjeti i shpërndarjes, uji monitorohet në pikën kur del nga rubineti;
 - b) Në rastin e ujit që vjen me cisterna, uji monitorohet në pikën kur del prej saj;
 - c) Në rastin e ujit të ambalazhuar në shishe ose enë të destinuar për shitje, uji monitorohet në pikën ku mbushen shishet dhe enët;
 - ç) Në rastin e ujit të përdorur në një njësi prodhimi ushqimor, uji monitorohet në pikën ku përdoret.
3. Monitorimi i ujit të destinuar për konsum publik kryhet nga IFBZ-ja ose institucione të tjera të njohura nga KMR-ja.

Neni 8

Mospërputhshmëria

1. Në rast se rezultatet e monitorimit të kryer në përputhje me nenin 7 tregojnë se përqendrimet e radiobërthamave i kalojnë nivelet e referencës të dhëna në nenin 6, personi që ka kryer monitorimin duhet të zbulojë shkakun e mospërputhshmërisë dhe duhet të njoftojë KMR-në.
2. Në raste të tilla siç referohen në pikën 1 të këtij neni, KMR-ja duhet të vlerësojë nëse kjo mospërputhje përbën një rrezik për shëndetin e njeriut dhe nëse duhet të merren masa.
3. Në rast se KMR-ja vlerëson se rreziku referuar në pikën 2, të këtij neni, është real, KMR-ja:
 - a) vendos të merren masa përmirësuese në përputhje me kërkesat e mbrojtjes së shëndetit të njeriut nga pikëpamja e mbrojtjes nga rrezatimi.
 - b) siguron që publiku:
 - të informohet për rrezikun dhe masat përmirësuese të nevojshme;

- të këshillohet për ndonjë masë paraprake shtesë që mund të nevojitet për mbrojtjen e shëndetit të njeriut nga materialet radioaktive.

Neni 9 **Përfashtimet**

1. Përcaktimet e neneve 6, 7 dhe 8 nuk aplikohen për:
 - a) ujërat minerale natyrale;
 - b) ujërat e përcaktuara si produkte mjekësore.
2. Uji i destinuar për konsum publik nga një furnizues individual që siguron mesatarisht më pak se 10m³ në ditë ose që shërben për më pak se 50 persona përjashtohet nga parashikimet e neneve 6, 7 dhe 8.

PJESA III

NIVELET E REFERENCËS PËR PRODUKTET BUJQËSORE TË KONTAMINUARA SI REZULTAT I NJË AKSIDENTI BËRTHAMOR OSE EMERGJENCE RADIOLOGJIKE

Neni 10

Nivelet e lejuara maksimale për ushqimet e kontaminuara me substanca radioaktive

1. Ndërfutja e qëllimshme e substancave radioaktive në prodhimin e ushqimeve është e ndaluar, si edhe import-eksporti i tyre.
2. Nivelet e lejuara maksimale nga kontaminimi radioaktiv i produkteve ushqimore si rezultat i një aksidenti bërthamor ose emergjence radiologjike janë përcaktuar në shtojcën 1 të kësaj rregulloreje.

Neni 11

Nivelet e lejuara maksimale të kontaminimit radioaktiv për ushqimet e kafshëve

1. Futja e qëllimshme e substancave radioaktive në prodhimin e ushqimit për kafshë është e ndaluar, si edhe import-eksporti i tyre.
2. Nivelet e lejuara maksimale nga kontaminimi radioaktiv i ushqimit për kafshë si rezultat i një aksidenti bërthamor ose emergjence radiologjike janë dhënë në shtojcën 2 të kësaj rregulloreje.

Neni 12

Nivelet e lejuara maksimale të kontaminimit radioaktiv për produktet e kozmetikës

1. Futja e qëllimshme e substancave radioaktive në prodhimin e produkteve kozmetike është e ndaluar, si dhe import-eksporti i tyre.

2. Nivelet e lejuara maksimale nga kontaminimi radioaktiv i produkteve kozmetike nga kontaminimi i një ose më shumë përbërësve të listuar në tabelën 2 të shtojcës 1, duhet të nxirren nga nivelet e lejuara maksimale që janë dhënë në tabelën 1 të shtojcës1. Në rast se produktet kozmetike nuk përfshihen ose nuk janë pjesë përbërëse e elementeve të listuara në tabelën 2, nivelet e lejuara maksimale merren duke iu referuar kolonës së fundit për produktet ushqimore të tjera.

Neni 13

Rishikimi i niveleve të lejuara maksimale

Nivelet e lejuara maksimale të përcaktuara në shtojcat 1 dhe 2 të kësaj rregulloreje mund të kufizohen përkohësisht, të plotësohen ose të rishikohen, me propozim të KMR-së, në varësi të rrethanave të veçanta, në rast të një aksidenti bërthamor ose emergjence radiologjike.

Neni 14

Kontrolli i importeve

1. Produktet bujqësore të importuara nga vendet e prekura nga një aksident bërthamor ose emergjencë radiologjike do të dalin në treg vetëm nëse këto produkte u nënshtrohen procedurave doganore në territorin e doganës së Republikës së Shqipërisë, në përputhje me “Udhëzuesin e procedurave për lëvizjen fizike të materialeve radioaktive, mallrave dhe reagimit në rast incidenti me burime radioaktive në pikat doganore”, i miratuar në bazë të ligjit nr.8025, datë 9.11.1995, “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, të ndryshuar.
2. Procedura e kontrollit në pikat e kontrollit kufitar referuar në pikën 1, të këtij neni konsiston në kontrollin e dokumentacionit, identitetit dhe kontrollin fizik, duke përfshirë marrjen e mostrave dhe analizat laboratorike të radiobërthamave në pika kufitare hyrëse ,siç janë specifikuar në shtojcat1 dhe 2 të kësaj rregulloreje. Kontrolli i tyre bëhet nga AKU-ja. Produktet ushqimore duhet të jenë të shoqëruara me raport analize në lidhje me përmbajtjen e përqendrimit të radiobërthamave. Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave civile njofton AKU-në në rast aksidenti bërthamor ose radiologjik.
3. Produktet, që nuk përmbushin kërkesat e kësaj rregulloreje, nuk do të dalin në treg dhe do të depozitohen në mënyrë të sigurt ose do të kthehen në vendin e origjinës.
4. Të gjitha shpenzimet që rezultojnë nga kontrollet zyrtare të referuara në pikën 2, të këtij neni, si dhe të gjitha masat që merren në vijim nga mospërmbushja e kërkesave, siç specifikohet në pikën 3, të këtij neni, do të përballohen nga importuesi.

Neni 15

Kontrolli i eksporteve

1. Eksporti i produkteve bujqësore të kontaminuara si rezultat i një aksidenti bërthamor ose emergjence radiologjike lejohet vetëm nëse eksportuesi do të demonstrojë

nëpërmjet matjeve të dokumentuara në certifikatën e eksportit, se respektohen nivelet e lejuara maksimale të përcaktuara në shtojcat 1 dhe 2 ose se janë në përputhje me nenin 13 të kësaj rregulloreje.

2. Certifikata e eksportit referuar pikës 1, të këtij neni, plotësohet duke përdorur modelin e dhënë në shtojcën 3.
3. Certifikata e eksportit referuar pikës 1, të këtij neni, shoqëron çdo ngarkesë produkti.
4. Certifikata e eksportit lëshohet nga persona fizikë ose juridikë, të njohur nga KMR-ja, në përputhje me udhëzuesin e miratuar për këtë qëllim, në bazë të ligjit nr.8025, datë 9.11.1995, “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, të ndryshuar.”

PJESA IV

Neni 16

Nivelet e referencës të rrezatimit gama të emetuar nga materialet e ndërtimit

Ekspozimi i jashtëm në mjediset e brendshme të rrezatimit gama, i emetuar nga materialet e ndërtimit, do të kufizohet në 1 mSv në vit, në shtesë të ekspozimit të jashtëm në mjediset e jashtme.

Neni 17

Kontrolli i materialeve të ndërtimit

Çdo person fizik dhe juridik që ka për qëllim të nxjerrë në treg, përfshirë edhe import-eksportin, materialet e ndërtimit sipas llojeve të specifikuara në shtojcën 4 të kësaj rregulloreje:

- a) përcakton përqendrimin e aktivitetit të radiobërthamave të specifikuara në shtojcën 5 të kësaj rregulloreje;
- b) informon KMR-në për rezultatet e matjeve dhe përqendrimin e aktivitetit të indeksuar të radiobërthamave, siç është përcaktuar në shtojcën 5 të kësaj rregulloreje.

Neni 18

Tregtimi i materialeve të ndërtimit

1. Në qoftë se shuma e aktiviteteve të indeksuara të një materiali ndërtimi nuk e kalon vlerën 1, materiali mund të nxirret në treg dhe të përdoret për qëllime ndërtimi pa asnjë kufizim lidhur me aktivitetin e tij.
2. Në qoftë se shuma e aktiviteteve të indeksuara të një materiali ndërtimi kalon vlerën 1, materiali mund të dalë në treg vetëm nëse shitësi demonstroi përputhjen me nenin 16 të kësaj rregulloreje.

3. Materialet e ndërtimit, të cilat tejkalojnë nivelet e referencës të dhëna në nenin 16, mund të dalin në treg vetëm nën masa të përshtashme sigurie, të cilat do të përcaktohen nga KMR-ja sipas rastit.

Neni 19

Importi dhe eksporti i materialeve të ndërtimit

Të gjitha import-eksportet e materialeve të ndërtimit të listuara në shtojcën 4 duhen të kenë të përfshira në specifikimet teknike të materialeve vlerën e përqendrimit të aktivitetit të indeksuar, të llogaritur në përputhje me shtojcën 5, ose deklaratën e përjashtimit bazuar në llogaritjen e dozës në përputhje me nenin 18/ 2.

PJESA V

Neni 20

Kontrolli i skrapeve

1. Të gjitha qendrat e mëdha të grumbullimit të skrapit dhe instalimet e mëdha të riciklimit të skrapit, si edhe nyjat e rëndësishme të transitit të pajisen me sisteme dedektimi pasive të përshtatshme, të afta për të zbuluar praninë e burimeve radioaktive ose skrapeve të kontaminuara.
2. Personat fizikë dhe juridikë, përgjegjës për objektet e përmendura në pikën 1, të këtij neni, të marrin masat e nevojshme për të siguruar këshillim dhe asistencë teknike të specializuar në rastin e zbulimit të një burimi jetim ose skrapit të kontaminuar me radioaktivitet, në mënyrë që të sigurohet mbrojtja e punëtorëve dhe publikut nga rrezatimi, si dhe të bëhet sigurimi i burimit në ambientet e përshtatshme.
3. Në rastin e zbulimit të një burimi jetim ose skrapit të kontaminuar me radioaktivitet, personat fizikë dhe juridikë, përgjegjës për objektet e përmendura në pikën 1, këtij neni, të njoftojnë menjëherë KMR-në.

Neni 21

Dispozita të veçanta për instalimet e riciklimit të skrapit

1. Pa rënë ndesh me nenin 20, personat fizikë dhe juridikë, përgjegjës për instalimet e riciklimit të skrapit, të njoftojnë menjëherë KMR-në në qoftë se ata dyshojnë për ndonjë shkrirje ose veprim tjetër metalurgjik, me burim jetim ose skrap të kontaminuar me radioaktivitet.
2. Materialet e kontaminuara që rezultojnë nga shkrirja e burimeve radioaktive ose materialeve të kontaminuara nuk do të përdoren dhe nuk do të dalin në treg. Këto lëndë të përpunuara mund të depozitohen në vende të sigurta me miratimin e KMR-së. Për përpunimin e mëtejshëm të tyre duhet të merren lejet përkatëse në KMR.

3. Të gjitha pajisjet e përdorura për detektim të skrapeve të kontaminuara duhet të jenë të testuara dhe të kalibruara.

Neni 22

Informacion për punëmarrësit lidhur me skrapet

1. Personat fizikë dhe juridikë, përgjegjës për objektet e përmendura në nenin 20, informojnë punëmarrësit e tyre në lidhje me mundësinë për t'u përballur me burime jetime apo skrape të kontaminuara me lëndë radioaktive .
2. Punëmarrësit, të cilët mund të përballen me burime jetime ose skrape të kontaminuara me lëndë radioaktive, duhet:
 - a) të trajtohen në zbulimin vizual të burimeve radioaktive dhe kontejnerëve të tyre;
 - b) të kenë njohuritë dhe informacionin bazë për rrezatimin jonizues dhe efektet e tij;
 - c) të trajtohen për përdorimin e sistemeve të zbulimit;
 - ç) të informohen dhe të trajtohen për veprimet që ndërmerren në terren në rast të zbulimit të një burimi jetim apo skrapit të kontaminuar me lëndë radioaktive.

Neni 23

Importi dhe eksporti i skrapeve

1. Çdo person fizik ose juridik, që ka për qëllim të eksportojë skrap, siguron monitorimin e rrezatimit të skrapit dhe provon nëpërmjet një certifikate pastërtie që skrapit nuk është i kontaminuar me lëndë radioaktive.
2. Monitorimi i skrapit kryhet përpara se ngarkesa të largohet nga mjediset e furnizuesit.
3. Certifikata e pastërtisë së dërgesës referuar pikës 1, të këtij neni, hartohet duke përdorur formularin e dhënë në shtojcën 6 të kësaj rregulloreje dhe kjo do t'i bashkëngjitet dokumentacionit të ngarkesës së furnizuesit.
4. Çdo person fizik ose juridik, që kërkon të importojë skrap, siguron se materiali që pritet të pranohet nuk është i kontaminuar me lëndë radioaktive, duke kërkuar një certifikatë të pastërtisë të dërgesës nga shitësi.

PJESA VI

DISPOZITA TË TJERA

Neni 24

Kontrolli i cilësisë

1. Të gjitha matjet e nevojshme, që kryhen për të verifikuar përputhjen me nivelet e përcaktuara në këtë rregullore, të bëhen me dedektorë të përshtatshëm dhe pajisje të kalibruara, të cilat u janë nënshtruar programeve të miratuara të sigurimit të cilësisë.
2. Matjet e specifikuar në nenet 4 /2, 5 /2, 7 /1, 14 /2, 15 /1 dhe 17 /a, kryhen nga institucione të njohura nga KMR-ja, në bazë të kriterëve të kompetencës.

3. Të gjithë laboratorët ku mostrat janë analizuar për qëllime të verifikimit të përputhshmërisë me nivelet e përcaktuara në këtë rregullore të kenë një sistem analitik të kontrollit të cilësisë.
4. Programet e monitorimit dhe metodat e matjes, të cilat do të përdoren për të verifikuar përputhshmërinë me nivelet në këto rregullore, miratohen nga KMR-ja.
5. KMR-ja inspekton zbatimin e dispozitave të kësaj rregulloreje.

SHTOJCA 1

NIVELET E LEJUARA MAKSIMALE TË KONTAMINIMIT RADIOAKTIV TË PRODUKTEVE USHQIMORE PAS NJË AKSIDENTI BËRTHAMOR OSE NJË EMERGJENCE RADIOLOGJIKE

Tabela 1. Nivelet e lejuara maksimale të kontaminimit radioaktiv të produkteve ushqimore pas një aksidenti bërthamor ose një emergjence radiologjike.

	Përqendrimi i aktivitetit (Bq/kg or Bq/l) në produktet ushqimore ¹				
	Ushqim për bebe ²	Qumështi dhe produktet e tij ³	Produkte ushqimore të lëngshme ⁴	Produkte ushqimore të thata ⁵	Produkte ushqimore të tjera
Izotopet e stroncium-it, veçanërisht Sr-90	75	125	125	7500	750
Izotopet e jodit, veçanërisht I-131	150	500	500	20000	2.000
Izotopet Alfa emetues të plutonit dhe elementet e familjes së plutonit, veçanërisht Pu-239, Am- 241	1	20	20	800	80
Të gjitha bërthamat e tjera me periudë gjysmëzbërthimi më të madhe se 10 ditë (përveç C-14 dhe H-3), veçanërisht Cs-134 dhe Cs-137	400	1.000	1.000	12.500	1.250

Shënime

1. Për produktet ushqimore të thata ose të përqendruara, niveli duhet të llogaritet në bazë të produktit të përpunuar gati për konsum.
2. Ushqime për bebe janë ushqimet e destinuara për ushqyerje të veçantë të fëmijëve gjatë 4 deri 6 muajve të parë të jetës. Këto ushqime plotësojnë të gjitha kërkesat e vlerave ushqimore për këtë kategori dhe janë vendosur në paketime për shitje me pakicë dhe me etiketa të qarta “ushqim i përgatitur për fëmijë”.
3. Produktet për të gjitha llojet e qumështit
4. Produktet ushqimore të lëngshme
5. Produktet ushqimore të thata janë përcaktuar në tabelën 2.

Tabela 2.Lista e produkteve të thata

Përshkrimi
Hudhra (e freskët ose e thatë)
Kërpudha (e freskët ose e thatë)
Kërpudha (të thata, të plota, të prera, të thyera, pluhur, por jo të përpunuara)
Salep, karcof i Jeruzalemit, patate e ëmbël dhe rrënjë të ngjashme ose zhardhokë me përmbajtje të lartë niseshteje ose inuline, të freskëta ose të thata, të prera me feta ose në formë të rrumbullakët; miell palme.
Lëkurat e agrumeve ose pjepri (përfshirë shalqi), të freskëta, të ngrira, të thara apo të ruajtura përkohësisht në ujë me kripë, në ujë sulfur apo në solucione të tjera ruajtëse/ konservuese .
Piper, fruta të thata ose të shtypura të gjinisë.
Vanilje
Kanellë dhe lule e pemës së kanellës.
Karafili
Fara anise, kopër, koriandër, qimnon /kumin, manaferra ose frutat e dëllinjave.
Xhinxher, shafra, trumzë dhe erëza të tjera.
Miell, miell palme, rrënjë ose zhardhokë të kreut nr. 0174.
Niseshte
Bimë dhe pjesë të bimës (duke përfshirë farat dhe frutat), llojet e të cilave përdoren kryesisht në parfumeri, në farmaceutikë, si : insekticide, fungicide ose për qëllime të ngjashme. Këto përdoren të freskëta ose të thata, të prera ose jo, të grimcuara ose pluhur.
Çdo produkt kozmetik.
Gomë natyrale, rezinë, rezinë-gomë dhe balsamet.
Ekstrakte dhe tretësira (lëngje) bimore/vegjetale, substancë pektike, pektina dhe pektate, agar-agar dhe lëndë të tjera ngjitëse ose trashëse, nëse janë të modifikuara ose jo, që rrjedhin nga produkte bimore.
Yndyrnat, vajrat dhe fraksionet e tyre që nxirren nga peshku ose gjitarët detarë, nëse janë ose jo të rafinuar, por jo të modifikuar kimikisht.
Kaviari dhe zëvendësuesit e kaviarit.
Farat/fasulet e kakaos, e tërë ose e thyer, e papërpunuar ose e pjekur.
Guaska/lëvozhga e kakaos, lëkura dhe mbeturina/pjesë të tjera të kakaos.
Pastë kakao, nëse është ose jo e yndyrosur
Kërpudha (të përgatitura ose të ruajtura, ku përjashtohen ato në uthull dhe acid acetik).
Frutat, arrat, lëvoret e frutave dhe pjesët e tjera të bimëve, të ruajtura në sheqer (të thara, të sheqerosura ose të kristalizuara).
Majatë (aktive ose joaktive); mikroorganizmat e tjerë njëqelizorë, të vdekur; (por nuk përfshihen vaksinat e kreut nr.3302); pudër majaje e përgatitur për pjekje.
Provitaminat dhe vitaminat, natyrale apo të riprodhuara me anë të sintezës (përfshirë koncentre natyrore), derivatet e përdorura kryesisht si vitamina dhe përzierës për sa më sipër, nëse janë ose jo në ndonjë tretës.
Duhani, cigaret, cigaret elektronike.
Vajrat esenciale (të terpenes ose jo), përfshirë të ngurta dhe absolute; rrëshirat; koncentratet e vajrave esenciale në yndyrna, në vajin yndyror, në dyllë apo edhe të marra nga tretja e gjetheve të thara; nënproduktet terpenike që merren nga deterpenimi i vajrave esenciale; distilatet ujore e solucionet ujore të vajrave esenciale.

SHTOJCA 2

NIVELET MAKSIMALE TË LEJUARA PËR KONTAMINIMIN RADIOAKTIV TË USHQIMEVE PËR KAFSHËT SI REZULTAT I NJË AKSIDENTI BËRTHAMOR OSE NJË EMERGJENCE RADIOLOGJIKE

Nivelet maksimale të lejuara për kontaminimin radioaktiv ushqimeve për kafshët jepen në tabelën 1. Nivelet e dhëna në tabelën 1 (shtojca 2) do të zbatohen për ushqime të gatshme për konsum nga kafshët.

Tabela 1. Nivelet maksimale të lejuara për kontaminimin radioaktiv të ushqimeve për kafshët si rezultat i një aksidenti bërthamor ose një emergjence radiologjike.

Kafshët	Përqendrimi i aktivitetit (Bq/kg) i Cs-134 dhe Cs-137
Derra	1.250
Shpendët, qengjat, viçat	2.500
Të tjerë	5.000

SHTOJCA 3
SHEMBULL. CERTIFIKATË EKSPORTI PËR PRODUKTET BUJQËSORE

(Kjo certifikatë mund të adoptohet nga laboratorët përkatës për çdolloj produkti)

Deklarata nga eksportuesi		
1. Ekportuesi (emri, adresa e plotë, shteti)	5. Vendi/shteti i origjinës	6. Vendi i destinacionit
2. Marrësi i ngarkesës (emri, adresa e plotë, shteti)	7. Numri i faturës	
3. Identiteti i mjeteve të transportit	8. Numri dhe lloji i pakove	9. Shenjat dhe numrat e serisë
4. Përshkrimi i produkteve	10. Pësja bruto (kg)	11. Pësja neto (kg)
12. Unë, i nënshkruari, përgjegjës për këto eksporte, vërtetoj informacionin e mësipërm:		
Data..... Emri Mbiemri(me shkronja kapitale).....		
Vendi Firma (¹):		
Certifikata nga laborator		
13. Numri i mostrave të analizuar për produktet e mësipërme, të marra nga një përfaqësues i autorizuar nga autoritetet kompetente	15. Identiteti i laboratorit (emri, adresa e plotë, vendi)	
..... Copë	16. Specifiko pajisjen e përdorur për kryerjen e analizave:	
14. Nivelet e radioaktivitetit të regjistruara për çdo mostër të analizuar (Bq/kg) (specifiko numrin. e serisë për çdo mostër)	17. Të akredituara nga (emri dhe adresa e trupës së akreditimit):	
Nr. i Raportit Data <i>Ky raport duhet të paraqitet menjëherë në kërkesën e autoriteteve të kontrollit</i>	18. Data:	
	Emri Mbiemri i personit përgjegjës (me shkronja kapitale) :	
	Firma e personit përgjegjës (¹):	
	Vula e laboratorit (¹):.....	
Certifikata nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit		
18. Unë, i nënshkruari, vërtetoj që niveli i radioaktivitetit i akumuluar për Cs-134 dhe Cs-137 në produktet e përmendura më sipër nuk i tejkalon limitet:		
Emri Mbiemri (me shkronja kapitale)..... Firma (¹):.....		
Data	Vendi	Vula (¹):

1.Firmat dhe vulat duhet të jenë në një ngjyrë të ndryshme nga ajo e tekstit.

SHTOJCA 4
LLOJET E MATERIALEVE TË NDËRTIMIT QË MERREN NË KONSIDERATË
LIDHUR ME EMETIMET E RREZATIMIT GAMA

Për qëllime të nenit 17, llojet e materialeve të ndërtimit si më poshtë, të kontrollohen:

1. Materiale natyrale:
 - a) argjila;
 - b) materiale ndërtimi, duke përfshirë:
 - granitet
 - inerte të ndryshme
 - tullat me përbërje të ndryshme
 - hekur për ndërtim
2. Mbetjet e materialeve që vijnë nga industritë përpunuese ku lidhen në mënyrë të natyrshme materiale radioaktive, duke përfshirë:
 - a) allçi/ gips fosfori;
 - b) skorje të ndryshme
 - c) argjilë/ baltë e kuqe (mbetje nga prodhimi i aluminit)
 - ç.) mbetje nga prodhimet e çelikut
3. Çdo lloj tjetër material ndërtimi për të cilin KMR-ja ka arsye të besojë që ekspozimi i brendshëm për shkak të rrezatimit gama i këtij materiali mund të kalojë nivelet e referencës të dhëna në nenin 16.

SHTOJCA 5

INDEKSI I PËRQËNDRIMIT TË AKTIVITETIT PËR EMETIMIN E RREZATIMIT GAMA NGA MATERIALET E NDËRTIMIT

Për materialet e ndërtimit të listuara në shtojcën 5, aktiviteti i përqendrimit të Ra-226, Th-232 (ose produkti i shkatërrimit të Ra-228) dhe K-40 do të përcaktohen në përputhje me nenin 17 /a.

Indeksi i përqendrimit të aktivitetit do të llogaritet në përputhje me nenin 19 / b duke përdorur vlerat e matura të përqendrimit të aktivitetit të Ra-226, Th-232 dhe K-40 dhe formulën, si më poshtë:

$$I = \frac{C_{Ra-226}}{300Bq/kg} + \frac{C_{Th-232}}{200Bq/kg} + \frac{C_{K-40}}{3000Bq/kg}$$

ku:

C_{Ra-226} , C_{Th-232} dhe C_{K-40} janë përqendrimet e aktivitetit në Bq/kg të radiobërthamave përkatëse në materialin e ndërtimit.

Indeksi lidhet me dozën e rrezatimit gama në shtesë të ekspozimit natyror në një ndërtesë me material ndërtimi sipas shtojcës 5. Indeksi zbatohet për materialet e ndërtimit, jo për përbërësit e tyre, përveç rasteve kur këta përbërës janë materiale ndërtimi dhe vlerësohen si të tillë.

Vlera e indeksit të përqendrimit të aktivitetit 1 të përdoret si një instrument konservativ shqyrtimi për identifikimin e materialeve që mund të shkaktojnë tejkalimin e niveleve të referencës të dhëna në nenin 16. Në qoftë se indeksi e tejkalon vlerën 1, doza e publikut duhet të llogaritet duke marrë në konsideratë edhe faktorë të tjerë si: densiteti, trashësia e materialit, tipi i ndërtimit dhe qëllimi i përdorimit të materialit, (në pjesën më të madhe të tij apo sipërfaqësore).

SHTOJCA 6

SHEMBULL.CERTIFIKATA E MONITORIMIT TË NGARKESËS SË SKRAPIT:

VENDI I MONITORIMIT	
Vendi i monitorimit:	
Emri i kompanisë/ institucionit dhe personit që drejton monitorimin:	
Adresa:	
Tel/fax:	
E-mail:	
DETAJE TË NGARKESËS	
Vendi i origjinës:	
Origjina e ngarkesës së mallit/ mallrave (adresa, personi i kontaktit, tel/fax, e-mail)	
Destinacioni i dërgesës: (informacion i detajuar i marrësit, kontakte)	
Identifikimi i ngarkesës: (referenca të dokumenteve të transitit që vijnë me ngarkesën)	
Mënyra e transportit: (identifikimi i kamionit, anijes, konteinerit etj.)	
Detaje të transportuesit: (informacion i detajuar i transportuesit, kontakte)	
MATJET	
Detaje të aparaturave të përdorura gjatë monitorimit:	
Vlerat mesatare të matura 1m nga sipërfaqja e ngarkesës (µSv/h):	
Vlera e dozës maksimale në kontakt me sipërfaqen e jashtme të konteinerit, kamionit ose vagonit, në µSv/h (identifikimi i pozicionit):	
Vlerat e rrezatimit mjedisor në zonë, në µSv/h:	
VËRTETIM I DEKLARATËS	
Unë, i nënshkruari, vërtetoj që vlerat e mëposhtme, janë një dokument i vërtetë i matjeve të bëra gjatë monitorimit në datën si më poshtë:	
Firma.....	
Vula zyrtare e kompanisë/ institucionit monitorues:	